

L I G J
Nr.8254, datë 12.11.1997

**PËR KOMISIONIN PARLAMENTAR TË HETIMIT TË NGJARJEVE QË KANË
NDODHUR NË SHQIPËRI NË PERIUDHËN JANAR-QERSHOR TË VITIT 1997**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të pikës 4 të vendimit nr.343, datë 7.10.1997 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit Popullor, për hetimin e ngjarjeve të periudhës janar-qershor të vitit 1997", me propozimin e deputetëve Spartak Ngjela dhe Pandeli Majko

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë veprimtarinë e Komisionit Parlamentar të hetimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë periudhës janar-qershor të vitit 1997, në mënyrë që të sqarojë para opinionit publik shqiptar përgjegjësinë për ato.

2. Komisioni ka për qëllim përpilimin e një relacioni përfundimtar, në të cilin duhet të tregohen në mënyrë të detajuar të gjitha shkaqet e përgjegjësitë, edhe ato me karakter penal, në bazë të një analize objektive, të hetuara për çdo person të veçantë ose grup personash.

Neni 2
Përcaktime

Me "komision" duhet të kuptohet gjithmonë Komisioni Parlamentar i hetimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri në periudhën janar-qershor të vitit 1997, i ngritur me vendimin nr.343, datë 7.10.1997.

Me dëshmitar në procesin e pyetjeve nga komisioni, kuptohet personi me këtë cilësi sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Pozita e "personit të pyetur në hetim", nuk është e barabartë me pozitën e të pandehurit, parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Ky person është i pyeturi që rezulton me të dhëna serioze përgjegjësie në lidhje me ngjarjet objekt hetimi.

Koncepti i akuzës, arresti e ndalimi, parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të përdoret në asnjë rast nga ky Komision.

KREU II
FUQITË E KOMISIONIT

Neni 3

Komisioni ka të njëjtat fuqi me autoritetet gjyqësore, në lidhje me:

thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve;

thirrjen e pyetjen e personit të pyetur në hetim;

thirrjen dhe pyetjen e çdo deputeti të Kuvendit Popullor, si dëshmitar ose si person në hetim.

Neni 4

Mbledhja e dokumenteve dhe informatave

Komisioni ka të drejtë:
të kërkojë nga organet gjyqësore kontrollin në banesat private të personave të pyetur në hetim.
Për personat që gëzojnë imunitet veprohet sipas dispozitave ligjore në fuqi;
të këqyrë dokumentet sekrete në të gjitha instancat e pushtetit shtetëror dhe të mbledhë informata edhe pranë autoriteteve më të larta shtetërore;
të kontrollojë dokumentet sekrete të policisë dhe të Shërbimit Informativ Kombëtar;
të kontrollojë dokumentet sekrete bankare.

Neni 5

Procedura

Për gjithshka që nuk është parashikuar në këtë ligj, do të procedohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria e komisionit nuk pengohet dhe as nuk mund të pengojë veprimtarinë e organeve të tjera.

KREU III

MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT

Neni 6

Elementet e përgjegjësisë

Komisioni ka për detyrë t'i bëjë të njohur më parë atij që do të pyetet si person në hetim, cilët janë elementët e përgjegjësisë të bazuar mbi të dhënat serioze që ai disponon, me qëllim që t'i japë mundësi të paraqesë justifikimet e tij.

Neni 7

E drejta e mbrojtjes

Personi që pyetet sipas përmbajtjes së nenit 6 të këtij ligji, mund të mbrohet me një avokat.

Neni 8

Pyetja e dëshmitarit

Komisioni ka të drejtë që të thërrasë në pyetje edhe persona të tjerë me cilësinë e dëshmitarit dhe, sipas rastit, të bëjë ballafaqimet e nevojshme sipas normave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 9

Xhirimi audioviziv

Në mënyrë që veprimtaria e komisionit të jetë sa më transparente, procesi i pyetjeve sipas gjykimit të komisionit duhet të përfshijë xhirimin audioviziv.

Xhirimet audiovizive përbëjnë sekret shtetëror dhe mund t'i jepen medias vetëm me vendim të komisionit. Ruajtja e tyre bëhet sipas normave të ruajtjes së provës ligjore.

Neni 10

Votimi

Komisioni vendos gjithmonë me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 11

Kuorumi

Procesi i pyetjeve nga komisioni dhe vendimet e tij janë të vlefshme vetëm në rast se plotësohet kuorumi i tij.

Neni 12

Rradha e votimit

Rradha e votimit në komision bëhet sipas moshës, duke filluar nga më i riu. Kryetari i komisionit voton gjithmonë i fundit.

Neni 13

Konsulentët teknikë

Nga rradhët e Prokurorisë së Përgjithshme, komisioni zgjedh konsulentë dhe ekspertë teknikë sipas propozimit të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

Konsulentët, sipas rastit, mbajnë procesverbalin e pyetjeve; ata mund të ngarkohen nga komisioni për të kryer veprimet procedurale të këqyrjeve dhe marrjes së dokumenteve, fakteve, provave materiale etj.

Neni 14

Komisioni gjatë veprimtarisë së tij fton ekspertë të huaj si vëzhgues në procesin hetimor.

Neni 15

Nëse një anëtar i komisionit ose kryetari, rezulton se duhet të pyetet nga komisioni, në pozitën "e personit të pyetur në hetim", ai duhet të japë dorëheqjen. Në rast se e refuzon këtë, me propozim të Komisionit (jo më pak se 6 vota) Kuvendi Popullor vendos shkarkimin e tij dhe zëvendësimin me një anëtar tjetër sipas modaliteteve të vendimit nr.343, datë 7.10.1997 të tij.

Neni 16

Seancë pyetjesh në Kuvendin Popullor

Kuvendi Popullor ka të drejtë që në çdo kohë të thërresë ose të dëgjojë në seancë pyetjesh kryetarin e Komisionit.

Neni 17

Komisioni duhet të bëjë publikisht të njohur adresën e tij dhe çdo qytetar ose institucion ka të drejtë t'i drejtohet atij për problemet që ai njuh në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Neni 18

Sekret shtetëror

Deri në relacionin përfundimtar të Kuvendit Popullor, të gjitha dokumentet, aktet dhe diskutimet e tij, përbëjnë sekret shtetëror.

Neni 19

Relacioni përfundimtar

Përveç vendimeve të ndërmjetme që Komisioni merr rast pas rasti, brenda funksionit të tij në lidhje me çështjen objekt hetimi, ai është i detyruar që, brenda një afati të caktuar nga Kuvendi Popullor, t'i paraqesë këtij në seancë plenare, relacionin përfundimtar të hetimit.

Neni 20

Kuvendi Popullor, me shumicë absolute votash miraton relacionin përfundimtar të Komisionit. Ky i fundit, për çështje të ndryshme, vendos nëse duhet ose jo t'ia kalojë këto organeve përkatëse, sipas propozimeve të bëra nga Komisioni.

Neni 21

Shpenzimet e Komisionit përballohen nga buxheti i Kuvendit Popullor sipas kërkesave që Komisioni i drejton Kryesisë së Kuvendit Popullor.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi më 1.11.1997.

Shpallur me dekretin nr.1957, datë 18.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.